

GJON BORIÇI**KREDIA E FUNDIT KINEZE PËR SHQIPËRINË (1974-1975) -
PRELUD I PRISHJES SË MARRËDHËNIEVE MES DY
VENDEVE. DILEMAT SHQIPTARE
NË MARRËDHËNIET ME KINËN**

Gjysma e parë e viteve '70 të shek. XX ishte dinamike përsa i përket marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndryshimeve që ndodhën në Evropë dhe në botë. Shqipëria komuniste vijonte të kishte marrëdhënie të ngushta vetëm me Kinën e madhe. Pas vizitës së presidentit amerikan Riçard Nikson (Richard Nixon) në Pekin, në shkurt të vitit 1972¹, Tirana zyrtare kishte filluar të mbante një qëndrim të ftohtë në marrëdhëniet me Kinën. Madje, Enver Hoxha nuk kishte ngurruar ta quante vizitën e Niksonit si tradhti ndaj marksizëm-leninizmit, duke u shprehur në ditarin e tij për Kinën: "*Kinezët kanë devijuar ashtu si Hrushovi*".²

Vështirë të mos besosh se lideri shqiptar nuk e kishte kuptuar se pas njohjes ndërkombëtare të vendit të madh aziatik, pranimit të saj në OKB më 25 tetor 1971³, Shqipëria do të humbte peshën që kishte në marrëdhëniet me Kinën. Është gjithashtu e pamundur të imagjinohet se Shqipëria do të vijonte të ishte përjetë zëri i Kinës në forumet ndërkombëtare siç kishte ndodhur gjatë gjithë viteve '60. Situata atëherë kishte ndryshuar. Kina po avanconte me shpejtësi drejt një integrimi të gjithanshëm në arenën ndërkombëtare.

Nuk ishte puna se Enver Hoxha dhe klika e tij kishin frikë nga populli shqiptar. Shqiptarët për më shumë se dy dekada e gjysëm kishin jetuar nën një regjim të fortë diktatorial, ku nuk lejohej mendimi ndryshe, ku komandohej individi dhe turma, pasi përndryshe të priste burgimi apo edhe dënimi me vdekje. Mendimi dhe veprimi i lirë individual ishin përmbytur nga propaganda dhe komanda për "unitet" dhe, nëse nuk përfshiheshë në të ashtuquajturin unitet [nënkupto turmë], ishe i

¹ Margaret Macmillan, *Nixon and Mao: The week that changed the world*, New York: Random House, 2007, f. 21.

² Enver Hoxha, *Shënime për Kinën*, vëll. I, Tiranë: 8 Nëntori, 1979, f. 651.

³ Henry Kissinger, *White House Years*, New York: Phoenix Press, 2000, f. 784.

përfashtuar për gjithçka dhe nga gjithçka. Pra, në një mënyrë ose tjetër, rezistenca individuale ishte e pamundur. Psikologjia e turmës, e cila komandohej nga psikologjia e NJË-shit, vepronte siç urdhëronte NJË-shi, dhe i përkulej Kultit të NJË-shit. Ky stil politik e shoqëror vazhdoi derisa pati jetë vetë sistemi komunist në Shqipëri. Në këtë kontekst, shqetësimi se çfarë do të mendonte populli shqiptar nuk merrej fare në konsideratë nga udhëheqja komuniste e vendit.

Në Shqipëri një varg veprash industriale, bujqësore dhe ushtarake ishin në ndërtim e sipër me ndihmën e plotë të Kinës. Lënia përgjysëm e tyre do të ishte me pasoja tepër të rënda për ekonominë e brishtë shqiptare. Dhe mungesat ekonomike do të nxirrnin në pah të gjitha mungesat e dobësitë e tjera të regjimit komunist në Shqipëri.

Ekonomia e Kinës kishte hyrë në rrugën e pakthyeshme të hapjes ndaj perëndimit dhe vendi po merrte një rëndësi të jashtëzakonshme në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndërkohë, industria shqiptare po merrte frymë në saje të kredive për ndërtimin e fabrikave dhe të uzinave nga Kina. Bujqësia sapo kishte dalë nga metodat pothuajse mesjetare të prodhimit, ku kolektivizimi i tokës, i krahëve dhe mjeteve të punës po ngecte, sidomos në zonat malore. Arritje relative kishin pasur fermat e mëdha bujqësore me investime shtetërore, si dhe komplekset e mbarështimit të kafshëve, por prodhimi i tyre ishte i pamjaftueshëm për të siguruar mishin dhe nevojat për zarzavate e fruta për të gjithë popullsinë. Ishte një fakt i hidhur që shqiptarët jetonin me pjesën e prodhimeve më të dobëta pasi pjesa më e mirë e produkteve bujqësore e blegtorale eksportohehin.

Fillimi i vitit 1974 ishte i vështirë për ekonominë e vendit. Më 17 janar 1974, ministri i Tregtisë, Kiço Ngjela, e informoi Enver Hoxhën se çmimet e tregtisë me Kinën për vitin 1974, do të pësonin një rritje nga e cila Shqipëria do të vendosej në vështirësi të mëdha.⁴ Rieksporti, sipas ministrit shqiptar, do të pësonte një rritje nga 2.3 deri në 3.4 milion rubla.⁵ Kiço Ngjela e arsyetonte këtë me rritjen e çmimeve në vitin 1974 dhe pohonte se ekonomia shqiptare ishte shumë e dobët për të përballuar

⁴ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/AP-MPKK, V. 1974, dosja (më tej: D.) 2, fl. 1. Informacion i kryetarit të Këshillit të Ministrave të RPSH, Mehmet Shehu dhe letër e ish ministrit të Tregtisë, Kiço Ngjela, drejtuar Enver Hoxhës mbi bisedën e zhvilluar me delegacionin tregtar të RP të Kinës të kryesuar nga ministri i Tregtisë Li Cian.

⁵ Po aty, fl. 5.

një diferencë të tillë. Ai sugjeronte të pranohej propozimi i palës kineze që diferenca e çmimeve të mbulohej vetëm me rritjen e çmimit të naftës bruto në nivelin e çmimit që Shqipëria shiste në vendet kapitaliste dhe se ky veprim të bëhej vetëm për vitin 1974, për vitet e tjera kinezët nuk e pranonin pagesën në këtë mënyrë.⁶

Më 25 janar 1974, kryeministri Mehmet Shehu i dërgoi Enver Hoxhës një informacion të hollësishëm lidhur me marrëdhëniet kino-amerikane.⁷ Aty, thuhej shumë qartë, se Kina dhe SHBA do të lidheshin ngushtë nga ana ekonomike dhe se SHBA-ja do ta furnizonte Kinën me satelitët më modernë për të parashikuar në kohë lëvizjet e trupave ushtarake sovjetike në kufi.⁸ Në këtë informacion lexohet qartë guximi i tepruar i Mehmet Shehut i cili, në formën e një këshille, i shkruan sekretarit të Parë të PPSH-së, të ndërhynte në procesin e normalizimit të marrëdhënieve kino-sovjetike, duke e nxitur Kinën që të mos i bëjë asnjë lëshim palës sovjetike, vetëm nëse qeveria sovjetike pranonte gabimet ndaj Kinës.⁹ Pra, Shqipëria, pa ia kërkuar askush, duhej të merrte përsipër rolin e moderatorit në marrëdhëniet e dy partive më të mëdha në Lëvizjen Komuniste Ndërkombëtare, rol i cili në rrethanat e atëhershme ishte i paracaktuar për të dështuar.

Ato që lexoi nga informatat e ministrave të tij, e paralajmëruan Enver Hoxhën se vështirësi të reja e prisnin Shqipërinë në të ardhmen. Këto informacione vinin kur Hoxha mendonte se e kishte vënë në udhë planin e tij për një ekonomi shqiptare me cikël të mbyllur prodhimi. Deri atëherë, ndihmat kineze në ekonominë shqiptare kishin qenë të rëndësishme.

Kur planet mujorë, gjashtëmujorë e vjetorë filluan të mos realizoheshin, kur mallrat e eksportit, të konsumit të gjerë dhe të ushqimeve të përditshme filluan të mungonin, vështirësitë në ekonominë shqiptare u bënë më të mëdha. Pas tyre erdhën dyshimet, të cilat u artikuluan në akuza dhe dënime të rënda, madje edhe për njerëzit që deri “një natë më parë” ishin lavdëruar për përkushtim në punën e tyre. Vargu i armiqve imagjinarë u shtua, dhe në të u përfshinë ministra, zëvendësministra, specialistë të aftë, punëtorë të devotshëm, e shumë e

⁶ *Po aty.*

⁷ *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1974, D. 2, fl. 1. Mbi kompensimin e vlefës së rieksportit të mallrave që Kina blen nga vendet e tjera për Shqipërinë me çmime më të larta.

⁸ *Po aty.*

⁹ *Po aty.*

shumë të tjerë. Në këtë çoroditje ekonomike dhe psikologjike, në maj 1975 u pushkatua Abdyl Këllezi, zëvendëskryeministër, anëtar i Byrosë Politike e deri tek dënimi me internim dhe burg të gjatë i Kiço Ngjelës, Vasil Katit, zëvendësministër i Tregtisë etj.¹⁰ Si të gjithë diktatorët, edhe Enver Hoxha nuk bënte dallim për t'i quajtur sukseset merita të vetat, ndërsa dështimet t'ua faturonte të tjerëve.

Karakteristikë është se as për dënimet në ushtri dhe as për dënimet në ekonomi, nuk u përmend asnjë akuzë për “bashkëpunimin e fshehtë” të të akuzuarve me palën kineze. Arsyeja ishte se ende vazhdonin marrëdhëniet ekonomike, ushtarake ndërmjet dy vendeve dhe, në fund të fundit, synohej të përfitohej, sa mund të përfitohej. Madje, për disa nga eliminimet politike që kishin ndodhur në Shqipëri, Enver Hoxha informoi edhe vetë miqtë kinezë. Kështu, më 30 shtator 1974, ai takoi ambasadorin kinez në Tiranë, Liu Xhen Hua, dhe i shpjegoi atij sesa armik i rrezikshëm paskësh qenë Beqir Balluku dhe, falë vigjilencës së partisë, ai ishte demaskuar dhe likuiduar.¹¹ Ambasadori kinez e dinte shumë mirë që Beqir Balluku kishte qenë tre herë në Kinë, madje kishte nënshkruar edhe marrëveshje të rëndësishme mes dy vendeve dhe, me shumë kujdes, e quajti likuidimin e ish ministrit shqiptar të Mbrojtjes Popullore një fitore të Enver Hoxhës.¹² Takimi mes Enver Hoxhës dhe ambasadorit kinez u bë në prag të përgatitjeve për të dërguar një delegacion të nivelit të lartë në Kinë, i cili do të kërkonte një kredi të re.

Shqipëria dhe Kina: negociatat e fundit për kredi ekonomike

Që marrëdhëniet shqiptaro-kineze kishin filluar të merrnin rrokullimën ishte shumë e dukshme edhe në arenën ndërkombëtare. Në një telegram sekret të dërguar nga Praga më 5 janar 1974, ambasadori finlandez në Çekosllovakia i kishte raportuar qendrës se marrëdhëniet kino-shqiptare kishin pësuar ngrirje.¹³

¹⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, Tiranë: Toena, 2009, f. 300.

¹¹ *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1974, D. 12, fl. 8. Biseda e sekretarit të Parë të KQ të PPSH, shokut Enver Hoxha, me ambasadorin e Kinës, Liu Xhen Hua, në darkën e shtruar me rastin e 25-vjetorit të Republikës Popullore të Kinës, datë 30 shtator 1974. - Mbi zbulimin e veprimtarisë armiqësore të Beqir Ballukut.

¹² *Po aty*.

¹³ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), V. 1974, D. 98, fl. 3. Mbi marrëdhëniet midis dy vendeve.

Në këtë kohë, në marrëdhëniet shqiptaro-kineze vihet re një sarkazëm e hidhur nga ana e miqve kinezë. Në një telegram sekret dërguar Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë më datë 24 tetor 1974, nga ambasadori Behar Shtylla, thuhej se zëvendës drejtori i Përgjithshëm i firmës Mashino Impex, kishte deklaruar: "*ne [kinezët] nuk i kemi kryer mirë detyrat karshi vendit tuaj dhe se ndihma që i keni dhënë partisë dhe vendit tonë është një ndihmë shumë e madhe. Ndihma e Shqipërisë në kohën kur social-imperialistët sulmuan partinë dhe vendin tonë në Bukuresht, përkrahja e gjithanshme në revolucionin kulturor dhe tani në luftën kundër Lin Biaos e Konfucit si dhe mbështetja e politikës sonë të jashtme as që mund të krahasohet me ndihmën ekonomike, me disa hidrocentrale e uzina që i japim Shqipërisë. Ja pse ne themi që nuk e kemi kryer mirë detyrën ndaj Shqipërisë heroike*".¹⁴

Heroike apo jo, Shqipëria nuk mund të jetonte me "fjalët e mira" kineze. Vendi mbetej ende shumë prapa zhvillimit jo vetëm botëror, por edhe atij rajonal. Viti 1974 nuk pati asnjë ndihmë domethënëse ekonomike për Shqipërinë përveç punës së specialistëve kinezë që jetonin këtu dhe ndihmonin në përmirësimin e punës në veprat që ishin ndërtuar apo që ishin në ndërtim e sipër nga kreditë kineze. Pesha e rëndësës ekonomike nga tkurrja e kredive dhe ndihmave që vinin nga Kina po fillonte të ndjehej në Shqipëri.

Në gjysmën e parë të vitit 1975, Shqipëria vijonte me politikën e saj në përkrahje të çdo nisme dhe anëtarësimi të Kinës në organizata ndërkombëtare.¹⁵ Në takimin e zhvilluar më 3 mars 1975 në Ministrinë e Jashtme të Shqipërisë ndërmjet diplomatëve shqiptarë dhe këshilltarit të ambasadës kineze Han Po, u fol në lidhje me procedurën për të propozuar kandidaturën e Kinës në Komitetin Ekzekutiv të Organizatës Botërore të Meteorologjisë, ku sipas informatave që kishte mundur të siguronte Shqipëria, kjo mund të arrihej vetëm gjatë zhvillimit të punimeve të Kongresit nga vetë shteti përkatës ose nga një shtet tjetër që bënte pjesë në Komisionin e Nominacioneve.¹⁶

Më 24 mars 1975, Shqipëria ndërmori nismën që Kina të anëtarësohej në Organizatën Olimpikë Botërore.¹⁷ Shqipëria vijonte të

¹⁴ *Po aty*, fl. 186-187.

¹⁵ *Po aty*, V. 1975, D. 129, fl. 4. Kërkesa për përkrahje dhe përkrahja në organizata të ndryshme të Kinës nga vendi ynë.

¹⁶ *Po aty*, fl. 11.

¹⁷ *Po aty*, fl. 14.

tregonte një zell të madh në përkrahje të çdo nisme kineze dhe të çdo pretendimi kinez për t'u anëtarësuar plotësisht në organizmat ndërkombëtarë. Por, zelli diplomatik e politik i Shqipërisë nuk po jepte frytet e duhura. Enver Hoxha dhe e gjithë udhëheqja komuniste shqiptare ishte e ndërgjegjshme për këtë. Duhej patjetër të dërgohej një delegacion qeveritar i nivelit të lartë që të negocionte marrëveshjen për një kredi të re nga ana e Kinës. Më në fund, pas shumë insistimeve nga ana e ambasadorit shqiptar në Kinë, Behar Shtylla, qeveria kineze pranoi të vinte në Pekin një delegacion i lartë qeveritar shqiptar i kryesuar nga zëvendëskryeministri Adil Çarçani. Synimi i delegacionit shqiptar ishte të siguronte një kredi të re kineze për pesëvjeçarin VI 1976-1980.¹⁸

Enver Hoxha dhe rrethi i tij i ngushtë politik, ishin të ndërgjegjshëm për vështirësitë që do të haste delegacioni shqiptar në Pekin. Ishte një vizitë tepër delikate që mbante në vetvete përgjegjësi të mëdha. Në mënyrë që delegacioni shqiptar të ishte sa më i përgatitur, më datë 11 qershor 1975, tre ditë përpara se të nisej për në Kinë, në zyrën e Enver Hoxhës në Komitetin Qendror, mbahet një mbledhje sekrete.¹⁹ Në atë takim ishin të pranishëm përveç Enver Hoxhës, Mehmet Shehu, Hysni Kapo, Haki Toska, Adil Çarçani dhe Petro Dode*.²⁰

Që në fillim të takimit, Enver Hoxha vuri në dukje se miqësia me kinezët duhej të vijonte, pavarësisht vështirësive, mbi bazën e frymës së marksizëm-leninizmit.²¹ Udhëheqësi shqiptar kërkonte nga delegacioni që të diskutonte me shokët kinezë për ndihma, që kishin të bënin me të ardhmen e vendit në kushte e rrethana të veçanta.²² Mendimet, sipas Enver Hoxhës, duhet të shpreheshin qartë: "*të mos i përtypim nëpër dhëmbë ato që dëshirojmë t'u bëjmë të ditur, por kujdes kurdoherë që fjalët dhe qëndrimet tona të jenë miqësore, të dëgjojmë me kujdes edhe*

¹⁸ *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1975, D. 2, fl. 2. Shënime nga takimi i sekretarit të Parë të KQ të PPSH Enver Hoxha me anëtarë kryesorë të delegacionit ekonomik shqiptar që do të shkojë në RP të Kinës, të kryesuar nga anëtari i Byrosë Politike dhe zëvendëskryetar i parë i Këshillit të Ministrave Adil Çarçani, datë 14 qershor 1975, ku jepen udhëzime mbi kredinë e re që do t'i kërkohet Republikës Popullore të Kinës për pesëvjeçarin VI 1976-1980 të RPSH dhe disa vërejtje për fjalimin e përgatitur nga delegacioni.

¹⁹ *Po aty*, fl.1.

* Petro Dode, zëvendëskryeministër i dytë i RPSH.

²⁰ *Po aty*.

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*.

ata kur të parashtrojnë pikëpamjet e tyre".²³ Delegacioni shqiptar do të paraqitej me dy variante në kërkesën e kredisë për pesëvjeçarin VI. Kërkesa e parë kishte të bënte me mundësinë e marrjes së një kredie prej 1 miliard e 200 milion rubla.²⁴ Nëse kinezët nuk binin dakord për këtë shumë, atëherë Enver Hoxha këshillonte të kërkohej shuma prej 650 milion apo 600 milion rubla.²⁵ Por, ajo që të bie më së shumti në sy është gatishmëria totale e Enver Hoxhës për të marrë çdo lloj shume sado të vogël, siç shprehej ai vetë "...sikur edhe pesë grosh të na japin, prapë ne duhet të flasim atje për miqësinë e përbashkët".²⁶ Kjo për faktin se nëse prishej me Kinën, varkë tjetër shpëtimi në botë për Shqipërinë nuk do të gjendej më.

Gjatë diskutimit, Enver Hoxha bëri edhe një vërejtje të fortë përsa i përket fjalimit që do të mbante delegacioni shqiptar. Vërejtja kishte të bënte me përmendjen e emrit të Beqir Ballukut, ku flitej për punën sabotuese të atij vetë dhe të grupit të tij.²⁷ Enver Hoxha kërkoi që emri i Beqir Ballukut dhe i grupit të mos përmendej fare pasi mund të dilnin probleme prandaj të mos ziheshin emra në gojë.²⁸ Por kishte një problem: Shqipëria duhej të justifikonte problemet e saj ekonomike që të kishte gojë t'i kërkonte Kinës kredinë e re për pesëvjeçarin VI. Beqir Balluku dhe ish anëtarë të tjerë të Komitetit Qendror të PPSH të pushkatuar, kishin shkuar disa herë në Kinë, ishin prezantuar si njerëz besnikë të Partisë e të popullit dhe kishin nënshkruar edhe marrëveshje në emër të Shqipërisë. Mehmet Shehu mendonte se emri i Beqir Ballukut duhej të përmendej patjetër si shkaktari kryesor i problemeve ekonomike dhe ushtarake të Shqipërisë.²⁹ Megjithatë, ajo që shqetësonte shumë udhëheqësit komunistë shqiptarë ishte se sa para do të akordonin kinezët. Mehmet Shehu mendonte që delegacioni të ishte këmbëngulës dhe madje të shkonte deri aty sa, "*në qoftë se shokët kinezë nuk do të na japin ndihma në nivelin që do të ishte i kënaqshëm për situatat tona, pra aq sa*

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1975, D. 6, fl. 70. Kopjet e marrëveshjeve dhe të protokolleve të përfunduara midis qeverisë së RPSH dhe Qeverisë së RP të Kinës mbi dhënien e një kredie me afat të gjatë dhe shkëmbimin e mallrave për pesëvjeçarin e gjashtë 1976-1980.

²⁵ *Po aty*, F. 14./AP-MPKK, V. 1975, D. 2, fl. 3.

²⁶ *Po aty*, fl. 2.

²⁷ *Po aty*, fl. 5.

²⁸ *Po aty*.

²⁹ *Po aty*, fl. 6.

kemi parashikuar në variantin bazë dhe do të na akordojnë, ta zemë, 500 ose 550 milionë rubla, mendoj t'ua shprehim haptazi që ndihma e dhënë nga ana e tyre është e pakënaqshme për ne".³⁰ Por, Enver Hoxha nuk ishte i prirur të prishej me kinezët prandaj ai porositi në mënyrë këmbëngulëse:

"Mund t'ua thonë dhe t'ua argumentojnë shokët përse është e pakënaqshme ndihma në këtë nivel, sepse duke mos qenë e mjaftueshme, një gjë e tillë do të ndikojë negativisht në gjendjen e brendshme politike dhe në atë të mbrojtjes së vendit tonë. Vërejtjet shokëve kinezë t'ua bëjmë, por siç theksova dhe po e përsëris, në çdo rast me ton të qetë, në mënyrë që fjalët tona të mbeten, ata t'i kenë të qarta pikëpamjet tona, kurse përjashta, me popullin, qëndrimet e shokëve të delegacionit tonë të jenë të pandryshuara, njëlloj si edhe më parë. Bëni kujdes të madh edhe në bisedimet që do të bëni vetë veçanërisht kur të diskutoni për variantet".³¹

Në fund të mbledhjes, Enver Hoxha këshilloi edhe një herë Adil Çarçanin dhe Petro Doden, si anëtarët më të rëndësishëm të delegacionit shqiptar, që të bënin kujdes me fjalët dhe, mbi të gjitha, të kishin parasysh ruajtjen e miqësisë me Kinën.³²

Kërkojmë kredi për "bukën e popullit"

Delegacioni i lartë qeveritar shqiptar i kryesuar nga zëvendës-kryeministri Adil Çarçani u nis për në Pekin më datë 14 qershor 1975 sipas programit të miratuar. Të nesërmen, më datë 15 qershor, delegacioni shqiptar u prit për 15 minuta nga kryeministri Çu En Lai.³³ Kryeministri kinez ishte i sëmurë dhe delegacionin shqiptar e priti në pavijonin e spitalit ku ishte shtruar. Çu En Lai nuk dëshironte të dëgjonte asnjë nga kërkesat e delegacionit shqiptar pasi mjekët e kishin këshilluar që të pushonte.³⁴ Të gjitha problemet dhe kërkesat që do të paraqiste

³⁰ *Po aty.*

³¹ *Po aty.*

³² *Po aty*, fl. 12.

³³ *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1975, D. 6, fl. 8. Nga biseda e delegacionit ekonomik qeveritar shqiptar me Çu En Lain, nënkryetar i KQ të Partisë Komuniste të Kinës dhe Kryetar i Këshillit të Shtetit të RP të Kinës, zhvilluar më 15 qershor 1975.

³⁴ *Po aty*, fl. 9.

delegacioni shqiptar, do të diskutoheshin me Li Hsien Nienin*, Fan I**-në dhe të tjerë.³⁵

Pak përpara se të mbyllte takimin, Çu En Lai këshilloi anëtarët e delegacionit shqiptar të lajmëronin udhëheqjen shqiptare që të shikonte mundësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit.³⁶ Por Adil Çarçani iu përgjigj krejt pa takt se për këtë çështje "*ne ndjekim vetëm qëndrimin parimor të shokut Enver të cilit i përmbahemi me vendosmëri*".³⁷ Këtu takimi u mbyll.

Më datë 16 qershor 1975, delegacioni shqiptar filloi negociatat e sikletshme me përfaqësuesit kinezë ku më këmbëngulësi për të mos u dhënë shumën e kërkuar të parave për kredi ishte Li Hsien Nien.³⁸ Bisedimet mes Adil Çarçanit dhe Li Hsien Nienit u zhvilluan me ndërprerje deri në datën 24 qershor 1975.³⁹ Sipas Li Hsien Nienit, kërkesat e Shqipërisë ishin të pabazuara dhe, për këtë arsye, Kina nuk do ta furnizonte më Shqipërinë me drithëra.⁴⁰ Adil Çarçani u mundua ta kthente bisedën në terma humanitarë duke i thënë Li Hsien Nienit se "*këtu kemi të bëjmë me bukën e popullit dhe ushqimin e tij të përditshëm dhe prerja e furnizimit me drithëra buke dhe mallra ushqimore Shqipërisë nga Kina Popullore, furnizim i cili ka formuar traditë në marrëdhëniet ekonomike midis dy vendeve tona vëllezër, nuk mund të mos ketë rrjedhime të këqija jo vetëm ekonomike, por edhe politike, e jo vetëm në gjendjen e brendshme, por edhe në gjendjen e jashtme të Shqipërisë*".⁴¹

* Li Hsien Nien (Li Xiannian), 23.06.1909-21.06.1992. President i Republikës Popullore të Kinës (1983-1988); zëvendëskryetar i Partisë Komuniste të Kinës (1977-1982); ministër i Financave (1954-1969); zëvendëskryeministër (1954-1980).

** Fan I (Fang Yi), zëvendëskryeministër i Kinës.

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty, fl. 10.

³⁷ Po aty, fl. 12.

³⁸ Po aty. Bisedë e zhvilluar më 16 qershor 1975, në Pekin, midis delegacionit ekonomik Qeveritar Shqiptar të kryesuar nga Adil Çarçani, me Li Hsien Nien, anëtar i Byrosë Politike të KQ të Partisë Komuniste të Kinës dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Shtetit të RP të Kinës.

³⁹ Po aty, fl. 53. Bisedë e zhvilluar më 24 qershor 1975 në Pekin midis delegacionit ekonomik Qeveritar Shqiptar të kryesuar nga Adil Çarçani me Li Hsien Nien, anëtar i Byrosë Politike të KQ të Partisë Komuniste të Kinës dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Shtetit të RP të Kinës.

⁴⁰ Po aty, fl. 58.

⁴¹ Po aty, fl. 59.

Por Li Hsien Nieni nuk u prek nga fjalët e bashkëbiseduesit të tij shqiptar. Ai i tha Adil Çarçanit se për Kinën ishte e pamundur t'i akordonte Shqipërisë një kredi prej 1 miliard e 200 milion yuan (800 milion rubla=850 milion\$).⁴² Kina, nëse Shqipëria ishte dakord, akordonte vetëm 500 milion yuan (225 milion rubla=250 milion\$).⁴³ Duke parë se Li Hsien Nieni nuk u prek nga mosdërgimi i "bukës për popullin", Adil Çarçani e ktheu bisedën në rrafshin ideologjik, duke deklaruar se *"armiqtë tanë janë njëkohësisht edhe tuajit, siç janë imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, të cilët luftojnë si kundër Kinës, ashtu edhe kundër Shqipërisë. Flotat e tyre sot ndodhen në afërsi të brigjeve shqiptare dhe na kërcënojnë. Po thuren komplete, në mënyrë të veçantë, kundër Shqipërisë, prandaj ne e themi këtë, demaskojmë qëllimet e tyre dhe përgatitemi për t'u mbrojtur, duke e konsideruar mbrojtjen e Atdheut si detyrë mbi të gjitha detyrat. Në të njëjtën kohë dhe pikërisht sepse paraqitet një situatë e tillë mendojmë se Shqipëria duhet ndihmuar e mbështetur me fuqimisht ekonomikisht dhe në drejtimet e tjera".*⁴⁴

Duke parashtruar edhe një herë me ton më të prerë kërkesën për një kredi prej 1 miliard 200 milion yuan ose të paktën 1 miliard yuan, Adil Çarçani mori këtë përgjigje përfundimtare prej Li Hsien Nienit:

*"Përgjigje tjetër nuk do t'ju japim. Përgjigja jonë siç e thamë edhe në takimin e fundit që bëmë, si edhe sot në këtë mbledhje është përfundimtare".*⁴⁵

Pa kundërshtuar dhe pa bërë zë, Adil Çarçani, duke patur edhe aprovimin paraprak nga Tirana në mbledhjen e 11 qershorit 1975, firmosi më 3 korrik 1975 në emër të Republikës Popullore të Shqipërisë marrëveshjen e re ekonomike me Republikën Popullore të Kinës.⁴⁶ Sipas kësaj marrëveshjeje, Shqipëria merrte nga Kina një kredi të re për pesëvjeçarin VI 1976-1980, në shumën e 500 milion yuan.⁴⁷ Shuma në fjalë ndahej në këtë mënyrë: për materialet e përgjithshme jepeshin 320 milionë yuan, ndërsa për veprat e plota jepeshin 180 milion yuan.⁴⁸

⁴² *Po aty*, fl. 61.

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ *Po aty*, fl. 69-70.

⁴⁵ *Po aty*, fl. 70.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 76.

⁴⁷ *Po aty*, fl. 75.

⁴⁸ *Po aty*.

Shlyerja e kredisë do të kryhej gjatë 10 vjetëve, duke filluar nga 1 janari 1991 deri më 31 dhjetor 2000, çdo vit me 1/10 e shumës së kredisë.⁴⁹

Me këtë kredi në Shqipëri do të përfundonin së ndërtuari një sërë veprash ku më e rëndësishmja ishte ndërtimi i plotë i hidrocentralit të Komanit me fuqi prej 600 mijë kw.⁵⁰ Një tjetër vepër që do të ndërtohej dhe që s'kishte lidhje me "bukën e popullit" ishte uzina e lëndëve eksplozive me aftësi prodhuese 5000 ton tritol në vit.⁵¹

Takimin e delegacionit shqiptar në Pekin, Enver Hoxha e konsideroi si fillimin e presionit të fortë ekonomik kinez.⁵² Informacioni që i vinte nga Adil Çarçani në Pekin ishte shumë dekurajues. Në bazë të marrëveshjeve që kishte nënshkruar delegacioni shqiptar, Kina i jepte Shqipërisë një kredi prej 500 milionë juanë e barabartë me 225 milion rubla kundrejt 813 milion rublave që kishte kërkuar Shqipëria.⁵³ Adil Çarçani në raportin e tij u shpreh se interlokutorët kinezë mbajtën një qëndrim shumë negativ. Akordimi i një kredie kaq të vogël dhe kufizimet që iu paraqitën palës shqiptare ishin sipas tij të paargumentuara, pasi më parë kinezët kishin deklaruar se, me t'u rritur fuqia e ekonomike e Kinës, edhe ndihmat për Shqipërinë do të shtoheshin.⁵⁴ Gjithashtu, pala shqiptare kërkoi që të jepej kredi për ndërtimin e 20 veprave të reja, por pala kineze akordoi vetëm 180 milion juanë (81 milion rubla) për të bërë të mundur ndërtimin e vetëm 10 veprave.⁵⁵

Për mallrat që delegacioni shqiptar i konsideroi të domosdoshme si grurë (350 mijë tonë), yndyrna ushqimore (25 mijë ton), sheqer (30 mijë ton), solar (225 mijë ton), gazoil (177 mijë ton), koks qymyrguri (143 mijë ton), yndyrna industriale (11.500 ton), lëkurë të përpunuara (2.600 ton), mineral hekuri për Kombinatin Metalurgjik në Elbasan (335 mijë ton) si dhe disa mallra të tjera nuk u siguruan fare financime.⁵⁶

Gjatë zhvillimit të bisedimeve, pala kineze, vuri dhe disa kufizime, ngriti disa probleme në këtë drejtim për t'u diskutuar në të ardhmen.

⁴⁹ *Po aty*, fl. 76.

⁵⁰ *Po aty*, fl. 87.

⁵¹ *Po aty*, fl. 90.

⁵² Enver Hoxha, *Shënime për Kinën*, vëll. II, Tiranë: 8 Nëntori, 1979, f. 107.

⁵³ *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1975, D. 6, fl. 3. Raporti i Adil Çarçanit për Enver Hoxhën.

⁵⁴ *Po aty*, fl. 4.

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ *Po aty*, fl. 5.

Interlokutorët kinezë njoftuan që brenda kredisë së akorduar përfshiheshin edhe mallrat për nevojat e ushtrisë, që kishin karakter përdorimi të përbashkët civil dhe ushtarak. U njoftua se pala kineze nuk do të furnizonte në të ardhmen drithëra buke, yndyrna ushqimore dhe mallra në rrugën e rieksporit. Gjithashtu, nuk do të furnizohej vendi me mallra që prodhoheshin në mënyrë të kufizuar dhe që nuk plotësonin nevojat e tyre. Përveç këtyre u njoftua se në të ardhmen do të diskutohej problemi i çmimeve për të kaluar nga çmimet stop*, në çmimet tregtare ndërkombëtare, si dhe për kushtet e lëvrimin të mallrave, lidhur me sigurimin nga ana shqiptare të transportit të tyre nga Kina në Shqipëri.⁵⁷

Shqipëria përgatitet për "luftë"

Dështimi i misionit për kredi të madhe nga ana e Adil Çarçanit nxiti Enver Hoxhën dhe Mehmet Shehun që të ndërmerrnin një iniciativë personale për të rinovuar marrëdhëniet me Kinën dhe për të parashtruar kërkesa të reja. Duke patur informata se dyshja Mao-Çu ishte rënduar nga shëndeti dhe nga mosha, Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu, më datë 12 nëntor 1975 nxitojnë t'i dërgojnë një letër të gjatë të dy udhëheqësve kinezë mbi nevojat e Shqipërisë për t'u furnizuar me armatime.⁵⁸ Kjo letër ishte shumë sekrete dhe, me vendim të Këshillit të Mbrojtjes u dërgua me persona të posaçëm për në Kinë: nga Ndreçi Plasari, anëtar i KQ të PPSH dhe Reis Malile, zëvendësministër i Punëve të Jashtme, të cilët u nisën për në Pekin më 22 nëntor 1975.⁵⁹

Letra ishte një dredhi e marrë e radhës e udhëheqjes kryesore shqiptare për të përfutur përsëri nga Kina. Që në fillim të saj, pasi lavdërohej Kina për ndihmat e mëdha dhe të pakursyera që i kishte dërguar Shqipërisë, jepeshin "argumentet" përse vendi kishte nevojë për armatime si pasojë e grupit "puçist" të Beqir Ballukut që kishte dëmtuar

* *Çmimet stop* - Transaksioni vihet në veprim nëse "çmimi stop" i përcaktuar nga blerësi në kontratë është më i ulët, ose i barabartë me çmimin aktual të tregut ndërkombëtar. Në rastin e shitjes, më i madh ose i barabartë me çmimin e tregut.

⁵⁷ *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1975, D. 6, fl. 6. Raporti i Adil Çarçanit për Enver Hoxhën.

⁵⁸ *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1975, D. 10, fl. 1. Letër e Komitetit Qendror të PPSH, datë 12 nëntor 1975 (firmosur nga Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu), drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, mbi gjendjen dhe nevojat për fuqizimin e mëtejshëm të vendit tonë me armatime e pajisje ushtarake nga ana e Kinës, si dhe dërgimin e një delegacioni ushtarak shqiptar për këtë qëllim në RP të Kinës.

⁵⁹ *Po aty*, fl. 12.

jashtëzakonisht shumë mbrojtjen e vendit.⁶⁰ Sipas Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut, "*Beqir Balluku, si revizionist i vjetër e armik i popullit, ka qenë një antikinez i shfrenuar, armik i miqësisë shqiptaro-kineze dhe del se ka punuar e intriguar me djallëzi, siç e pohoi vetë, për ta minuar këtë miqësi, sigurisht me porosi të revizionistëve sovjetikë*".⁶¹

Sipas udhëheqësve komunistë shqiptarë të kohës, pas kësaj "disfate të madhe" që pësuan revizionistët sovjetikë, ata po përpiqeshin të sulmonin Shqipërinë sipas dy mundësive: mundësia e parë e planit të tyre agresiv konsistonte në atë që goditja kryesore e operacionit ushtarak kundër Shqipërisë të jepej nga ana e ajrit, me desantim masiv ajror deri në 6-7 divizione parashutistësh, me baza nisjeje në Bullgari, Hungari dhe Ukrainë, duke kaluar mbi hapësirën ajrore jugosllave, me ose pa pëlqimin e Jugosllavisë, duke e kombinuar këtë edhe me goditjen ndihmuese që mund të jepej në bregdetin shqiptar nga ana e flotës ushtarako-detare sovjetike në Mesdhe. Qëllimi imediat i këtij operacioni do të ishte kapja e porteve detare, pushtimi i zonës fushore të bregdetit, i aerodromeve dhe i qyteteve kryesore, duke përfshirë edhe Tiranën. Me arritjen e këtyre objektivave, sipas Hoxhës dhe Shehut, ata do të kishin krijuar mundësitë për të sjellë nga ajri e deti edhe trupa të tjerë tokësorë, për të kaluar në fazën e dytë të operacionit që do të kishte për qëllim përfundimtar pushtimin e të gjithë territorit të Shqipërisë.⁶²

Mundësia e dytë e operacionit të supozuar agresiv ushtarak sovjetik kundër Shqipërisë ishte sipas Hoxhës dhe Shehut, varianti më i ndërlikuar dhe parashikohej të realizohej në rrethana luftarake shumë të turbullta në Ballkan, kur, pas vdekjes së Titos dhe kur të krijoheshin kushtet, ushtria bullgare dhe ajo sovjetike, ndoshta edhe me pjesëmarrjen e anëtarëve të tjerë të Traktatit të Varshavës, të kishin pushtuar të paktën Maqedoninë, në mos edhe pjesët e tjera të Jugosllavisë. Në këto rrethana, goditja kryesore kundër Shqipërisë mund të jepej po nga ajri me desantim masiv ajror, sikurse mund të jepej dhe nga kufiri tokësor, me bazë nisjeje nga territori i Maqedonisë. Në të dyja rastet operacioni do të kombinohej në të njëjtën kohë si nga ajri, ashtu dhe nga toka e deti.⁶³

Akoma më marrëzi në letrën e shkruar të 12 nëntorit 1975, ishte pjesa kur liderët komunistë shqiptarë njoftonin Kinën se kishin informata

⁶⁰ *Po aty*, fl. 2-3.

⁶¹ *Po aty*, fl. 3.

⁶² *Po aty*, fl. 4.

⁶³ *Po aty*.

nga Komanda e NATO-s për Evropën Jugore, se në Napoli të Italisë, kishte plane të përpunuara hollësisht për një sulm ushtarak eventual kundër Shqipërisë, për ta pushtuar Shqipërinë të paktën pjesërisht (bregdetin) në mos tërësisht, në rast se amerikanët do ta shihnin që sovjetikët po e sulmonin ose do ta sulmonin Shqipërinë. Këtu, sipas tyre, dukej shumë qartë e konkretisht rivaliteti i egër në veprim midis dy superfuqive edhe përsa i përkiste Shqipërisë.⁶⁴ Duke menduar se me këto "ëndrra në diell" do të bindnin lidërsipin e lartë kinez, në fund të letrës, Hoxha dhe Shehu shkruajnë:

"Ne ju lutemi, i dashuri shoku Mao Ce Dun dhe i dashuri shoku Çu En Lai, që ta shqyrtoni me dashamirësinë revolucionare që ju karakterizon këtë kërkesë të Partisë sonë. Ne nuk kemi aleat tjetër besnik kujt t'i kërkojmë armatim veç Kinës Popullore. Ne kemi besim të plotë se ju, si kurdoherë, do ta trajtoni dhe do t'i jepni zgjidhjen më të drejtë kësaj kërkesë, që ka rëndësi jetike për vetë ekzistencën e Shqipërisë si një vend socialist dhe për popullin tonë si një popull i lirë e sovran që ndërton dhe mbron socializmin në kushte shumë të vështira të rrethimit e të bllokadës së egër imperialiste dhe revizioniste. Ne propozojmë që të dërgojmë në Pekin sa më parë që të jetë e mundur dhe e përshtatshme për ju, një delegacion të posaçëm ushtarak për të trajtuar konkretisht me palën tuaj çështjen e armatimit të mëtejshëm të forcave tona të armatosura".⁶⁵

Shqipëria kërkonte një armatim shumë të madh që për kohën tejkalonte edhe mundësitë e Kinës për ta furnizuar Shqipërinë. Në fund të letrës paraqitej një pasqyrë përmbledhëse lidhur me armatimin që kërkonte Shqipëria.⁶⁶ Pasqyra përmbledhëse ishte si më poshtë:

1. -	Armë të lehta të këmbësisë (pistoleta, automatikë, pushkë, mitraloza, granata hedhës të lehtë, mortaja të lehta) ... copë.....	250.000
2. -	Mortaja të kalibrave 82-160,/m	" " 1.500
3. -	Topa pazmbrapsje kundërtank	" " 1.500
4. -	Topa fushorë	" " 600
5. -	Artileri reaktive 130m/m me larghedhje	" " (makina) 100
6. -	Mitroloza kundërajrorë dy dhe katër grykësh	" " 1.500
7. -	Topa kundërajrorë 37-100m/m	" " 600
8. -	Raketa kundërtanke në makinë dhe për në krahë	" " 1.500

⁶⁴ *Po aty*, fl. 5.

⁶⁵ *Po aty*, fl. 8-9.

⁶⁶ *Po aty*, fl. 9.

9.-	Raketa tokë-det.....	Grupe	4
10.-	Raketa kundërajrore të mesme.....	" "	4
11.-	Raketa kundërajrore të lehta për në krahë (tip Sam-7)	copë	..	1.000
12.-	Tanke	" "	...	800
13.-	Transportues të blinduar	" "	...	300
14.-	Aviona reaktivë luftarakë dhe mësimorë	" "	...	65
15.-	Helikopterë	" "	...	38
16.-	Katera	" "	...	24
17.-	Anije mbiujëse luftarake dhe ndihmëse	" "	...	18
18.-	Silura për nëndetëset dhe katerat silurues	" "	...	1.000
19.-	Municion për armët e lehta të këmbësoresë (fishekë)	" "	1.450.000.000
20.-	Predha mitralozash kundërajrore 12.7-14.5m/m	" "	150.000.000
21.-	Predha granatahedhësish të lehtë	" "	3.180.000
22.-	Predha mortajash të lehta (60 mm).....	" "	2.320.000
23.-	Predha mortajash 82 - 160 m/m	" "	1.600.000
24.-	Predha për topa kundërtank pazmbrapsje.	copë	1.500.000
25.-	Predha artilerie fushore 76-152 m/m	" "	2.500.000
26.-	Predha artilerie kundërajrore 37-100 m/m	" "	5.000.000
27.-	Predha për topat e avionave	" "	1.500.000
28.-	Raketa për avionat (ajër-ajër dhe ajër tokë).....	" "	100.000

Të gjitha këto armatime duhet të lëvroheshin për Shqipërinë në periudhën e viteve 1976-1980.⁶⁷ E gjithë kjo sasi armatimi kërkohej në një kohë kur s'kishin kaluar as katër muaj nga nënshkrimi i dokumentit të Konferencës së Helsinkit, proces i cili kishte çimentuar paqen në Evropë dhe kishte hedhur bazat për përfundimin e Luftës së Ftohtë. Mendësia tepër e prapambetur e komunistëve shqiptarë ishte jashtë çdo realiteti. Dyshja Mao Ce Dun-Çu En Lai nuk i ktheu asnjë përgjigje letrës së Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut. Marrëdhënia "e çeliktë" shqiptaro-kineze po përjetonte fundin e saj të trishtë për Shqipërinë, duke e çuar këtë të fundit drejt një vetizolimi të pashmangshëm.

Përfundime

Aleancat politike në çdo epokë të marrëdhënieve ndërkombëtare kanë qenë gjithnjë të pranishme. Janë arsye të forta ato që imponojnë krijimin e aleancave. Arsyeja e parë dhe kryesore ka qenë dhe mbetet sigurimi i të gjitha forcave në një front të vetëm dhe prania e ndihmesës

⁶⁷ *Po aty*, fl. 10,11.

reciproke. Aleancat krijohen edhe për të frenuar e parandaluar realizimin e një agresioni të mundshëm. Drejtimi i politikës kineze në botë ishte një përzierje mes ideologjisë dhe interesit kombëtar. Pranimi i Kinës në OKB dhe vizita e presidentit Nikson ishin qasjet e fundit të një lidhshipi në largim e sipër. Pragmatizmi i Mao Ce Dunit për të pritur presidentin amerikan ishte si rezultat i njohjes dhe mospranimit të politikës së brendshme të Bashkimit Sovjetik, politikë që sipas Xhorxh Kenanit (George Kennan) *do të sillte rënien e kësaj perandorie si rezultat i tensioneve të brendshme*.⁶⁸

Për vetë specifikat e regjimit komunist që aplikonin të dyja vendet, RP e Kinës dhe RP e Shqipërisë, marrëdhëniet ideologjike institucionalizoheshin nëpërmjet bashkëpunimit midis partive komuniste, të kthyer në parti-shtet të të dy vendeve. Kështu ndodhi edhe në rastin e marrëdhënieve politike Shqipëri – Kinë. Dy partitë komuniste, Partia e Punës e Shqipërisë dhe Partia Komuniste e Kinës, ishin institucionet kryesore politike dhe udhëheqëse të bashkëpunimit politik midis dy vendeve dhe popujve. Shtetet dhe institucionet ndërvarëse të tyre, legjislativi dhe ekzekutivi, ekonomia dhe kultura, ushtria dhe mbrojtja, të gjithë së bashku udhëhiqeshin nga komponenti ideologjik dhe vareshin institucionalisht nga udhëheqjet partiake.

Vitet 1974-1975 ishin shumë të vështira për politikën dogmatike që aplikonte Shqipëria dhe udhëheqësi i saj Enver Hoxha. Problemi i tij i madh ishte se nuk kishte një vend tjetër brutal stalinist ku të mbështetej pas prishjes së marrëdhënieve me Kinën. Në vend të hapjes së vendit, ai aplikoi politikën e vetizolimit dhe të mbështetjes në forcat e veta. Interesant është fakti se kjo ide u çimentua dhe u aplikua nga udhëheqësi komunist shqiptar pas raportit që i bëri zëvendëskryeministri Adil Çarçani kur u kthye nga Kina më 11 korrik 1975. Më hollësisht Çarçani këshillonte:

"Akordimi i kredisë në masën e mësipërme, sigurimi i mallrave në mënyrë të kufizuar dhe problemet që u trajtuan më sipër, do të na krijojnë sigurisht mjaft vështirësi në zhvillimin e ekonomisë sonë në pesëvjeçarin e gjashtë dhe në të ardhmen. Në këto kushte, për punën tonë, dalin një seri detyrash të rëndësishme si:

- Në radhë të parë duhet të bëjmë një punë të gjithanshme për të kuptuar thellë gjendjen dhe vështirësitë e për të siguruar një

⁶⁸ Xhorxh Kenan, *Diplomacia amerikane*, Tiranë: Dituria, 1997, f. 110.

mobilizim të përgjithshëm për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe rezervat që ka ekonomia jonë popullore, duke u mbështetur plotësisht në forcat e veta.

- Të përqendrojmë edhe më shumë forcat në fushën e bujqësisë sidomos për prodhimin e drithërave, yndyrnave, sheqerit, pambukut, që janë shumë të vështira për t'u siguruar nga importi.
- Të tregojmë kujdes të vazhdueshëm për zhvillimin e mineraleve dhe për realizimin e detyrave në këta sektorë, sidomos për naftën, kromin, bakrin etj.
- Të kufizojmë në maksimum ndërtimet e investimet jo prodhuese, duke përfshirë edhe sektorët arsimorë, social-kulturor dhe banesat. Të merren masa për thjeshtimin e ndërtimeve, duke përfshirë edhe ato të sferës prodhuese.
- Të forcojmë më tej regjimin e kursimit, sidomos në përdorimin e mallrave të importit dhe të materialeve të tjera deficiente.
- Të shtojmë përpjekjet për realizimin e eksportit, për të rritur numrin e artikujve dhe të sasisë së mallrave për eksport.
- Të merren masa disa masa të veçanta lidhur me planin e vitit 1975 (disa korigjime për gjashtëmujorin e dytë me qëllim që të kursehen lëndë të para e materiale) dhe për planin e vitit 1976-për kuotat që janë aprovuar për import-eksportin dhe ndërtimet, në drejtim të shkurtimit të tyre".⁶⁹

Kredia e 3 korrikut 1975, ishte kredia e fundit nga ana e Kinës. Porta kineze u mbyll përfundimisht për Shqipërinë komuniste të Luftës së Ftohtë.

⁶⁹ AQSH, F. 14/AP-MPKK, V. 1975, D. 6, fl. 6. "Mbi punën e delegacionit ekonomik qeveritar për përfundimin e marrëveshjeve ekonomike me RP të Kinës", protokollat e mbledhjeve që u bënë në shkallë delegacioni, si edhe protokollat përkatëse që u bënë me palën kineze për kredinë me afat të gjatë dhe shkëmbimin e mallrave për pesëvjeçarin e VI (1976-1980).

*S u m m a r y*THE LAST CHINESE LOAN TO ALBANIA 1974-1975 - A PRELUDE TO THE
COLLAPSE OF THE RELATIONSHIP BETWEEN THE TWO COUNTRIES

The year 1975 was very important for the European and world politics. On July 1975 was signed in the Helsinki Charter by every European country except Albania. More and more the country was sinking into a unprecedented self-isolation. The relations with China were reaching the lowest point ever. In the international relations, Albania continued to support China. By Albanian request, China was welcomed as a member of World Olympic Organization. This movement was highly acclaimed by Albania but didn't helped to improve the relations with China. Was required a stronger move. After long conversations by the Albanian ambassador, was agreed that a high delegation from Albania chaired by deputy prime minister Adil Çarçani was to be welcomed in China on June 14th 1975. The aim was to made e fresh request for e new credit for the sixth quinquennial 1976-1980. Enver Hoxha sentenced this meeting in his diary as very tense and as the beginning of economic pressure from the part of China. Adil Çarçani was sending daily detailed reports to the supreme leader about his visit. The information was very discouraging. China has agreed giving Albania a new loan of 500 million Yuen (225 million rubles) instead of 823 million rubles required by Albania. In his report, Adil Çarçani said that the Chinese counterpart showed a very negative attitude and the allocation of such a small loan according to him was not logical and without argument because before the Chinese had declared that the power of China has arisen and the aid toward Albania was to be increased. The Albanian delegation asked for the building of 20 new works but the Chinese have agreed only for 10.